- Per lidhjet familjare ne tubacione te reja HDPE, do te aplikohen fasheta veteshtrenguese elektrofuzive.
- Dimensionet e lidhjeve familjare do te jene ne varesi te numrit te konsumatoreve per lidhje etj. dhe/ose konsumatoreve me shumice dhe ne varesi te gjatesise se lidhjes familjare. Diametri i lidhjes familjare per cdo diameter tregohet netabelen meposhte.

Madhesia e Rekomanduar per Lidhjet Familjare

| Diametri i Lidhjeve te Shtepive | | Numri maksimal i matesave/ klienteve |
|---------------------------------|-------------------|--------------------------------------|
| D i brendshem Mm | D i jashtem mm | |
| 15 | 20 | 1 |
| 25 | 32 | 2-4 |
| 50 | 63 | 4-20 dhe komercial, institucional |

- Matesat familjare do te jene me madhesi ½ inch. Ujematesat ekzistues familjare do te zevendesohen vetem nese eshte e nevojshme, p.sh. nese jane te thyer, nuk punojne etj.
- Lidhjet familjare do te zevendesohen plotesisht dhe nese nevojitet, do te zhvendosen ne kufijte e prones dhe te gjitha punimet do te realizohen sipas specifikimeve dhe rregullave te Ujesjellesit. Matesat familjare do te vendosen ne kuti te sigurta matesash nese jane te vlefshme dhe/ose do te sigurohen nga konsumatori. Ne pergjithesi, eshte kerkuar nga UK qe ne kuadrin e ketij projekti te furnizohen kuti te reja per matesat.

Matesat familjare

Matesat mekanike me trup metalik, me fushe te thate jane ato me te perdorshmit ne gjithe boten. Matesi “standart” do te jete me madhesi ½ inch dhe klasa B. Nje valvul moskthimi do te instalohet para dhe direkt pas matesit te prurjes.

Saracineskat e Shkarkimit dhe Ajrimit

“Ndertim i Rrjetit shperndares te furnizimit me uje ne 14 fshatrat e Kolonjes”


Saracineskat e ajrimit dhe shkarkimit duhet te instalohen ne tubat e shperndarjes primare dhe sekondare sic kerkohet nga topografia. Instalimet jane propozuar si me poshte:

Ajruesit

Per tubacionin kryesor, do te instalohen saracineska ajrimi te tipit dalje e dyfishte ne tubat me diameter DN 200 ose me te medha. Ato do te vendosen ne pergjithesi ne piken me te larte te tubave DN 200 e me te medha dhe afer saracineskave te izolimit ne rastin e pjerresive. Ne pergjithesi, saracineskat e ajrimit duhet te instalohen si me poshte:

- Perpara pompave;
- Ne piken me te larte te shtratit vertikal dhe mbi kryqezime; ne te dyja anet e tubacioneve ne rastin e tubave te zhytyra thelle, p.sh. gjate kalimit te lumenjve;
- Cdo 500 m deri 1000 m ne seksionet gjatesore te tubave me pjerresi mesatare.

Per sistemet e shperndarjes ku lidhjet e konsumatoreve behen ne pjesen e sipërme te tubave nuk nevojiten te instalohen saracineskat e ajrimit, pervec rasteve te kalimit nga siper dhe ne pikat fundore te tubacioneve me diametra te medhenj.




Shkarkimet

Mund te konsiderohen dy lloje te ndryshme shkarkimi:

- Shkarkime ne zonat urbane: ne tubat e ujrave te shiut;
- Shkarkime ne zonat rurale ne kanale ose sipërfaqe toke.

Shkarkimet duhet te vendosen ne piken e poshtme te tubacionit, ose afer saracineskave te interseksionit, dhe aty ku eshte e mundur, shkarkim ne tubat e drenazimit, etj. Nje saracineske me pallote duhet te instalohet dhe sigurohet ne fundet e tubave te shkarkimit, ku ato te shkarkojne ne sistemin e drenazimit. Si rregull praktik shkarkimet duhet te konsiderojne zbrazen e seksioneve respektive te tubacioneve ne cdo 3 deri 4 ore.



Saracineskat

Instalimi i saracineskave duhet te bazohet ne konsideratat e meposhtme:

- Hapesira: saracineskat e izolimit duhet te instalohen ne intervalet e percaktuara, hapesira midis tyre diktohet nga faktore si kerkesat per shkarkim, lidhjet e konsumatoreve dhe lidhje te tjera ne tubacionin kryesor;
- Vendndodhjet e detyrueshme: saracineskat e izolimit duhet te sigurohen ne tubat e nderlidhura (T-te), lidhjet me by-pass te tubave, lidhjet hidrante, shkarkimet dhe ajrimet.

Parimet per instalimin e saracineskave te cilat do te adoptohen gjate projektimit, permblidhen si me poshte:

- Saracineska me hapje per tuba HDPE me diametra 40-110, me seksion te plote duhet te futen thelle ne toke dhe te pajisen me nje kuti sherbimi dhe me nje aks manovrimi.
- Saracineskat per diametrat e tubave nga 200 mm deri ne 400 mm duhet te jene me lartesi fikse dhe me seksion te plote. "Seksioni plote" do te thote qe saracineska te kete hapje te plote dhe eshte i disponueshem i gjithe seksioni i tubit per prurjen e ujit. Saracineska me "Lartesi fikse", avantazhet e tyre jane qe nuk e ndryshon lartesine dhe per diametrat e medhenj ne puseta standarte.
- Saracineskat duhet te instalohen ne puseta nese diametri eshte \geq DN200.
- Saracineskat e groposura duhet te operohen me akse manovrimi dhe box gize per diametrat \leq Dn200.
- Saracineskat me diameter 400 mm e me lart duhet te jene saracineska flutur.

Matesat Kryesore

Disa matesa kryesore uji zonale (DMA) do te instalohen brenda zonave te projektit. Tipi i matesave qe do te instalohet do te jete elektromagnetik, gjithashtu ato do te jene te pajisura me lexues elektronik te dhenash te instaluar ne nje kuti leximi.

Specifikimet e matesave do te jene si me poshte:


"Ndertim i Rrjetit shperndares te furnizimit me uje ne 14 fshatrat e Kolonjes"

- Matesa permanente elektromagnetike do te jene per instalimin ne tubacione me flanaxha integrale, per nje norme minimale presioni prej PN 10 ose 16 (sic kerkohet);
- Te pershtatshem per tu instaluar si mbi edhe nen toke dhe ne puseta;
- Te gjitha pajisjet elektronike duhet te jene rezistente ndaj ujit ne IP68;
- Cdo mates do te sigurohet me nje pike taposje e vendosur per tu lidhur me nje niples te lidhjeve te shtepiave;
- Matesat duhet te jene te gjendje te arrijne nje saktesi prej $\pm 0.5 \%$ te shpejtesise reale brenda nje game prej 0 deri 10 m/s.
Kerkesat per furnizim me energji duhet te jene si me poshte:
- Per njesite ne tubacionet kryesore, nje system furnizimi i avancuar me energji duhet te instalohet per cdo mates duke lejuar operimin ne 100 deri 245V AC ose me rezerva baterie per nje periudhe prej 24-oresh gjate shkeputjeve te energjise, per te siguruar qe nuk ka shkeputje te matjes, leximeve dhe transmetimit te te dhenave.
- Per njesite qe punojne me bateri, si njesia fundore dhe matesi duhet te jene ne gjendje te operojne per dy vite kur japin lexime cdo ore dhe transmetojne keto lexime nje here ne dite;
- Te gjitha baterite duhet te jene ne madhesi dhe voltazh standart te cilat gjenden me lehtesi ne treg.

Kutite qe mbajne dhe mbrojne pajisjet qe lidhen me matesat si baterite, lexuesit elektronik dhe pjeset elektronike duhet te mbyllen me celes, qendrojne ne ambientin e jashtem, te mbrojtura nga korrozioni dhe te instaluara me baza betoni.

Hidrantet

Vendndodhja, hapësira dhe numri i hidranteve per fikjen e zjarreve eshte nje ceshtje per tu diskutuar dhe rene dakort me brigadat perkatese te zjarrefikeseve. Ne pergjithesi, hidrantet e zjarrit do te jene pika shtese te instaluara ne tubacione sekondare ose me lart; ato do te instalohen ne rruge te gjera dhe do te jene te pershtatshme per lidhje me tubat e zjarrefikeseve. Nuk rekomandohet qe te jemi ne perputhje me disa standarte nderkombetare sipas te cilave nje hydrant zjarri duhet te instalohet cdo 150 metra. Pervec permbushjes se qellimit kryesor te furnizimit me uje te zjarrefikeseve, projektimi i hidranteve qe do te instalohen do te bazohet ne numrin e elementeve operacionale perkates.



Disa nga ceshtjet per t'u konsideruar jane:

- Sa uje (l/min) nevojitet per zjarrefikeset
- Sa dhe ne cfare madhesie kerkohen lidhjet per zjarrefikeset
- Ceshtje te qartesisise dhe dukshmerise
- Karakteristika operative te hidranteve
- Niveli i presionit statik ne rrjet
- Kushtet klimatike ne zona

Parimet konceptuale dhe specifike të projektimit të rezervuarëve do të bazohen në rekomandimet ndërkombëtare, rregullat dhe udhezimet në vijim:

- DIN EN1508, Furnizimi me ujë-Kërkesat për sistemet dhe komponentet për ruajtjen e ujit; Versioni gjerman EN1508:1998

si një grup kornizash me rregulla dhe specifikime në:

- DVWG (Shoqata Gjermane e Gazit dhe Sektorit të Ujërave)-Arbeitsblatt (Udhezimi) W300-1 (2013 Entwurf/draft), Trinkwasserbehälter-PLANUNG und Bau (depo te ujit -Projektim dhe ndërtim)
- DVWG (Shoqata Gjermane e Gazit dhe Sektorit të Ujërave)-Arbeitsblatt (Udhezimi) W300-3 (2013 Entwurf/draft), Trinkwasserbehälter-INSTANDSETZUNG und Verbesserung (depo te ujit rehabilitimin dhe përmirësimin)
- DVWG (Shoqata Gjermane e Gazit dhe Sektorit të Ujërave)-Arbeitsblatt (Udhezimi) W300-5 (2013 Entwurf/draft), Trinkwasserbehälter-Werkstoffe, Auskleidungs- und Beschichtungssysteme Anforderungen und Prüfungen (tanke e ujit -Materiale, rreshtim dheveshja Sistemet-kërkesat dhe testimi)

Duke përfshirë versionet e mëparshme të rekomandimeve të mësipërme në lidhje e detaje me sfond historik

- DVWG (Shoqata Gjermane e Gazit dhe Sektorit të Ujërave)-Arbeitsblatt (Udhezimi) W300(2005-

- 06), Wasserspeicherung-PLANUNG, Bau, Betrieb und INSTANDHALTUNG von Wasserbehältern der Trinkwasserversorgung (Rezervuare Uji-Projektim, ndërtim, Operacioni, Rehabilitimi nga rezervuarët e ujit përfurnizimin me ujë)
- DVWG (Shoqata Gjermane e Gazit dhe Sektorit të Ujërave)-Arbeitsblatt (Udhezimi) W312(1993-1911), Wasserbehälter-Maßnahmen zur INSTANDHALTUNG (rezervuarët e Shërbimit-Masat për mirëmbajtje)

Ligjet dhe rregulloret e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë ndër të tjera:

- Kushtet Teknike Shqiptar e te projektimit (“Kushtet Teknike Te Projektimit” KTP-11, 12, 13-1978)

Parimet konceptuale dhe specifike te projektimit per rezervuarët

Parimet e mëposhtme specifike konceptuale dhe të veçanta të projektimit dhe kriteret aplikohen për rezervuarët:

- Te pakten dy dhoma te ndara.
- Pozita e përshtatshme topografike për të siguruar presionin e kërkuar minimal në Zonën e Furnizimit.
- Projektimi i sistemit te mjedisit perreth duhet te jete ne sintoni me ambientin perqark
- Teresisht e izoluar/e mbuluar me dhe
- Materiale te pershtatshme per perdorimin ne kontakt me ujin e pijshem
 - Betoni sipas DVGW W 347
 - Aliazhe te lehta celiku dhe gize
 - Celik
 - Plastike e perforcuar me fibra xhami
 - Plastike (PE, PP)
 - Materiale plastike qe aplikohen ne forme te lengshme, me perberje bi-komponente rezine (Epoxidharz EP, Polyurethan PUR)
 - Qelq dhe pllaka si materiale per veshje, shtrese
- Baza e jashtme
 - E aksesueshme nga kamiona (me ngarkese deri SLW 60)
 - Mbushje skarpate me dhe 1:3
 - Siguria Rrethim minimal
 - Hapësira e nevojshme per magazinim materialesh si dhe përmasat rehabilituese dhe rinovime
 - Bime dekorative me rrenje te ceketa
 - Kerkesat Funktionale
 - Hyrje e lehte me masat e sigurise kunder aksidenteve
 - Dhoma e manovrimit / komandimit permbajtja e te gjitha tubave
 - Depot
 - Hyrje e vecante per secilen nga dhomat e rezervuarit
 - Shmangie e aksesit te drejtperdrejte ne nivelin e lire e te ujit dhe shmangie e rrezeve direkte te diellit

- Kontroll i dukshem nga salla e operimit, kontrollet operacionale duhet te jene te mundur pa ndotjen e rezervuareve
- Shpejtesi e pershtatshme e rrjedhjes dhe shmangia e fjetjes se ujit neper cepa
- Saracineska per te anashkaluar ujin jashte dhomave te rrezervuarit per arsye mirembajtje
- Vaska e kullimit ne piken me te ulet ne menyre qe rezervuari te jete plotesisht bosh

— Tubacionet

- Dimensione te pershtatshme
- Bypass midis tubit te hyrjes dhe atij te daljes ne rast mirembajtje
- Kuota e tubit te daljes ne menyre qe te optimizoje ne maksimum vellimin
- Teperplotesi me dimension te pershtatshem dhe me/ose galexhant ne hyrje
- Teperplotesi dhe shkarkuesi NUK DUHET te lidhen direkt me tuba qe jane per uje jo te pijshem (p.sh. tubat e drenazhimit)
- Marrja e mostrave ne hyrje dhe dalje
 - Sa me e shkurter qe te jete e mundur
 - Edizinfektueshme dhe rezistente ndaj zjarrit
 - E arritshme ne menyre te lehte

— Ventilimi

- Ventilim natyror me hapje te filtruar
- E vecante per cdo dhome
- Filter per te shmangur nderhyrjen e pluhrave, grimcat dhe insekteve
- Pike e paracaktuar per te thyer filterin ne rast bllokimi

— Strukturor

- Struktura e papershkrueshme ndaj ujit– kontroll per gjeresine e plasaritjeve
- Kontroll per stabilitetin e jashtem sipas Eurocode
- Kontroll per stabilitetin e brendshem sipas Eurocode
- Klasa e ekspozimit te betonit sipas Eurocode
- Marrja ne konsiderate e forcave vepruese per shkak te ndryshimit te temperaturave
- Beton jo poroz
- Reduktim dhe kufizim i levizjeve te nyjeve/bashkimit te levizshem tip cerniere. Nese eshte e pamundur te konsiderohet DIN 7865-1 dhe -2, DIN 18541-1 dhe -2 sikurse dhe DIN 18197

— Ndertimi

- Armature rezistente ndaj ujit per beton jo poroz
- Kufizo rrjedhjen/derdhjen e betonit
- Minimizim i aditiveve te betonit
- Pershtat receten e betonit sipas cilesise se ujit

“Ndertim i Rrjetit shperndares te furnizimit me uje ne 14 fshatrat e Kolonjes”

- Bashkimet ne nyje me shirita metalike te salduara min. 1.5mm trashesidhe 300mm gjeresi (sipas DIN EN 10051 (DIN 18197 te merret ne konsiderate)
- Kolaudimi / marrja ne dorezim
- Monitorimi i uljeve gjate mbushjes per here te pare
 - Testi i papershkrueshmerise para mbulimit te rezervuarit
 - Pastrim
 - Dizinfektim
 - Testet e cilesise se ujit ne lidhje me parametrat bakteriologjike
 - Lidhja me rrjetin
- Operim & Mirembajtje
- Paraqitja e dokumentave te rendeshishme dhe vizatimeve
 - Ndjekja e planit te mirembajtjes
 - Mirembajtja e higjenes
 - Kryerja e inspektimeve te rregullta
 - Monitorimi i cilesise se ujit

5. KERKESA PER UJE TE PIJSEM

Baza e perlllogaritjes

Projektimi i zhvillimit te popullsisë

Bilanci i uji

Parashikimi i kerkeses per uje eshte perlllogaritur duke marre ne konsiderate normen e rritjes se popullsisë, normen e lidhjes se konsumatoreve me rrjetin (100%) pas vitit 2020 (pas rehabilitimit te rrjetit) dhe duke konsideruar rreth 30% humbje ne vitin 2045.

Normativa e ujit per nje banor eshte presupozuar te rrije e pandryshuar **100 litra/banore/dite** nga 2020 deri ne vitin 2045 dhe per shkak te mungeses se te dhenave te konsumit te ndare sipas lojit te konsumatoreve eshte konsideruar se :

- kerkesa per uje per konsumatoret institucionale eshte sa 4% e kerkeses per uje per konsumatoret familjare
- kerkesa per uje per industrine eshte sa 6% e kerkeses per uje per konsumatoret familjare

6. KONCEPTET E PROJEKTIMIT

Koncepti hidraulik dhe projektimi

Eshte zgjedhur skema hidraulike e furnizimit me uje te pijshem me e pershtatshme per secilin fshat gjate hartimit te ketij projekti.

Koncepti hidraulik per ujesjellesin

Per trasimin e linjave te reja projekti u mbeshtet ne rrjetin rrugor te parashikuar ne planin urbanistik te bashkise Kolonje.

“Ndertim i Rrjetit shperndares te furnizimit me uje ne 14 fshatrat e Kolonjes”

Aktualisht fshatrat furnizohen me uje nga nje ose dy depo te cilat furnizohen ose nga burime natyrore ose nga ujesjellesi i linjes kryesore te Kozelit.

Ne tabelen e meposhtme kemi te dhenat e popullsisë te te 14 fshatrave te marra ne studim.

| Nr | Emertimi | Nr. I Banoreve viti 2020 |
|----|-----------|--------------------------|
| 1 | Starje | 172.00 |
| 2 | Selenice | 144.00 |
| 3 | Psar 1 | 57.00 |
| 4 | Psar 2 | 202.00 |
| 5 | Kreshove | 49.00 |
| 6 | Gosivisht | 191.00 |
| 7 | Bejkove | 60.00 |
| 8 | Mollas | 149.00 |
| 9 | Qinam | 876.00 |
| 10 | Qafzeze | 1,149.00 |
| 11 | Helmes | 387.00 |
| 12 | Shtika | 360.00 |
| 13 | Vodice | 325.00 |
| 14 | Skorovot | 89.00 |
| 15 | Rehova | 130 |

Prurja maksimale ditore llogaritet me formulën:

$$Q_{\text{ditore maksimale}} = Q_{\text{ditore mesatare}} * K_{\text{ditore}}$$

Kurse koeficienti i konsumit te mosnjetratshmerise orare (Korare) sipas KTP 11-78 rezulton nje vlere qe luhaetet midis 1.9557-1.8975.

Gjejme Numrin e rritjes se Popullsisë per t=25vjet me perqindjen e rritjes vjetore 2.5% me formulën:

$$N_2 = N_1(1+r)^t$$

Llogarisim Prurjet maksimale ditore per perdoruesit:

Ku n eshte norma mesatare e furnizimit me uje te pijshem n=100 l/banore ne dite

$$Q_{\text{ditore maksimale}} = \frac{N_2 * n}{1000} \text{ (m}^3\text{/dite)}$$

Llogarisim Prurjen mesatare orare per perdoruesit:

$$Q_{\text{orare}} = \frac{Q_{\text{ditore maksimale}}}{24} \text{ (m}^3\text{/ore)}$$

Llogarisim Prurjen maksimale orare:

$$Q_{\text{orare maksimale}} = Q_{\text{orare}} * K$$

“Ndertim i Rrjetit shperndares te furnizimit me uje ne 14 fshatrat e Kolonjes”

Llogarisim Prurjen llogaritese me qellim dimensionimin e rrjetit:

$$q_{90} = \frac{Q_{\text{mmmmmm}}}{3600}$$

Me ane te formulave te mesiperme jane bere llogaritjet e prurjeve dhe koeficenteve perkates per secilin Fshat, te pasqyruar ne tabelen e meposhtme.

| Nr | Emertimi | Popullsia ne vitin 2020 | Popullsia ne Vitin 2045 | K _o | Prurja maksimale ditore (m ³ /dite) | Prurja mesatare orare (m ³ /ore) | Prurja maksimale orare (m ³ /ore) | q _o |
|----|-----------|-------------------------|-------------------------|----------------|--|---|--|----------------|
| 1 | Starje | 172.00 | 320.00 | 1.89 | 32 | 1.6 | 3.02 | 0.8 |
| 2 | Selenice | 144.00 | 267.00 | 1.89 | 26.7 | 1.335 | 2.52 | 0.7 |
| 3 | Psar 1 | 57.00 | 106.00 | 1.89 | 10.6 | 0.53 | 1.00 | 0.3 |
| 4 | Psar 2 | 202.00 | 374.00 | 1.89 | 37.4 | 1.87 | 3.53 | 1.0 |
| 5 | Kreshove | 49.00 | 91.00 | 1.89 | 9.1 | 0.455 | 0.86 | 0.2 |
| 6 | Gosivisht | 191.00 | 354.00 | 1.89 | 35.4 | 1.77 | 3.35 | 0.9 |
| 7 | Bejkove | 60.00 | 111.00 | 1.89 | 11.1 | 0.555 | 1.05 | 0.3 |
| 8 | Mollas | 149.00 | 276.00 | 1.89 | 27.6 | 1.38 | 2.61 | 0.7 |
| 9 | Qinam | 876.00 | 1,605.00 | 1.89 | 160.5 | 8.025 | 15.17 | 4.2 |
| 10 | Qafzeze | 1,149.00 | 2,125.00 | 1.89 | 212.5 | 10.625 | 20.08 | 5.6 |
| 11 | Helmes | 387.00 | 716.00 | 1.89 | 71.6 | 3.58 | 6.77 | 1.9 |
| 12 | Shtika | 360.00 | 666.00 | 1.89 | 66.6 | 3.33 | 6.29 | 1.7 |
| 13 | Vodice | 325.00 | 602.00 | 1.89 | 60.2 | 3.01 | 5.69 | 1.6 |
| 14 | Skorovot | 89.00 | 140.00 | 1.89 | 13.9 | 0.695 | 1.31 | 0.4 |
| 15 | Rehova | 130 | 241.00 | 1.89 | 24.1 | 1.205 | 2.28 | 0.6 |

Rrjeti shperndares eshte dimensionuar per prurjen maksimale orare ne ditën me konsum maksimal.

“Ndertim i Rrjetit shperndares te furnizimit me uje ne 14 fshatrat e Kolonjes”

Kalimi i linjave ne toke publike

Pjesa me me madhe e linjave ekzistuese kalon ne rruge publike. Po keshtu dhe linjat e reja kryesore jane propozuar per t'u instaluar do te kalojne ne rruge publike duke menjanuar nevojen per shpronesim nga ana e bashkise.

Mbulimi i tubit

Mbulimi sipas standarteve eshte i rendesishem per jetegjatesine e tubit. Jetegjatesia e tubit varet nga nderveprimi midis tubit dhe materialit qe e rrethon dhe per kete nevojitet nje projektim sa me i mire i shtresave mbuluese ne kanal. Ne rastin e tubave me material fleksibel si HDPE kjo eshte vecanerisht kritike. Gjate jetes se vete te punes tubi i nenshtrohet veprimeve dhe kushteve te pafavorshme si mbushja, trafiku, grushti hidraulik, levizja e dheut. Prandaj nje projektim jo korrekt i kanalit, perdorimi i materialit te gabuar mbushes dhe ngjeshja e dobet do te rezultonte ne nje demtim te tubit.

Mbulimi i tubit duhet te behet ne shtresa sipas standartit EN 1610 dhe me material sipas DIN 4124.

Trasimi i linjave

Planimetrite e pergjithshme tregojne qe pjesa me e madhe e linjave te reja ndjek rruget ekzistuese. Profilet gjatesore te ndertuara tregojne kuotat dhe gjatesite e tubave. Te gjitha rrjetet e tjera te infrastruktures duhet te merren ne konsiderate gjate ndertimit si:

- linja telekomunikacioni
- linja ujesjellesi
- linja kanalizimesh
- linja elektriku


Lidhjet familjare

Lidhjet familjare ekzistuese do te zevendesohen deri tek kufiri i prones private. Lidhja me tubat ekzistues do te perfshihet ne cmimin e instalimit te tubit.


7. PROJEKTI I REHABILITIMIT TE UJESJELLESIT

Punime rehabilituese ne burimet e reja


- Ne Shtike Do te ndertohet nje depo e re me kapacitet 75 m³ shoqeruar me instalimin e nje pompe te re. Do te kryhen punime sistemimi, rrethim dhe porte hyrese. Gjithashtu do te instalohen matesa per matjen e prodhimit te ujit.




- Ne Skorovot Do te kryhen punime instalimi te linjave nga Ujesjellesi kryesor i Kozelit ne depo, punime sistemimi dhe rrethimi, gjithashtu dhe punimet per rrjetin e brendshem.




- Ne Kreshove do te ndertohet depo e re me kapacitet 75 m³ me punimet e instalimit, ndertimit, rrethimit dhe sistemimit, do te kryhen punime te instalimit nga Ujesjellesi kryesor i Kozelit ne depo, gjithashtu do kemi punime sistemimi, rrethimi dhe punime per instalimin e rrjetit te brendshem.



- Ne Starje do te ndertohet depo e re me kapacitet 75 m³ e shoqeruar me punimet e instalimit, ndertimit, rrethimit dhe sistemimit dhe rrjet te brendshem per lagjen 1.




Per lagjen 3 do te ndertohej depo e re me velligim 75 m^3 duke perfshire edhe punimet e instalimit, ndertimit, rrethimit dhe sistemimit dhe nje linje Transmetuese 450ml nga depo deri ne puseten grumbulluese ne hyrje te fshatit.



- Ne Gostivisht do te kryhen punime per Instalimin e Linjes nga linja kryesore e Ujesjellesit te Kozelit deri ne depo, gjithashtu do te kryhen punime per ndertimin e depove 75 m^3 si dhe punimet e instalimit te rrjetit te brendshem.



“Ndertim i Rrjetit shperndares te furnizimit me uje ne 14 fshatrat e Kolonjes”



Punime rehabilituese ne stacionet e pompimit


Gjate rehabilitimit te stacioneve te kryhen matjet e thellesise se shpimeve dhe te behet nje pastrim i tyre. Per mbrojtjen e shpimeve nga ndotjet e mundshme siperfaqesore rekomandohet te krijohet zona e rreptesise sanitare me rreze 50m dhe zona e mbrojtjes sanitare me rreze rreth 100m. Do te rehabilitohet rrethimi i jashtem si dhe do te zevendesohen pompat zhytесе dhe transformatori i rrymes.

Projekti parashikon zevendesimin e pompave zhytесе dhe te transformatorit te rrymes elektrike.


Punime rehabilituese tek depot ekzistuese dhe ndertimi i depove te reja.

Ne si konsulent inspektuam dhe verifikuam gjendjen funksionale te depove ekzistuese dhe u konstatuan qe disa prej ketyre kane arritur nje nivel shume te larte amortizimi. Duke bere nje vleresim tekniko-ekonomik ne keto raste eshte gjykuar me e arsyeshme dhe e pershtashme te ndertohen depo te reja se sa te rikonstrktohen ekzistueset. Po ashtu disa prej strukturave nuk shfaqin aktualisht probleme lidhur me qendrueshmerine por me kapacitetin qe kane nuk arrijne te mbulojne nevojat per uje te rrjedhshem te fshatrave dhe per kete arsye eshte propozuar ndertimi i nje depove te reja ne fshatrat e siper permendur. Depot jane me kapacitet te ndryshem si 75m³ dhe 100m³.


DEPO E RE
 $V = 100 \text{ m}^3$



PLANIMETRIA E DYSHEMESE



“Ndertim i Rrjetit shperndares te furnizimit me uje ne 14 fshatrat e Kolonjes”



Punime rehabilituese ne rrjetin shperndares dhe linjat e transmetimit

Per shkak te gjendjeve te amortizuara, rrjeti ekzistues ne fshatra do te zevendesohet plotesisht me tuba te rinj prej polietilene Tuba HDPE. Linjat do te shtrihen ne rruge duke shmangur kalimin ne prone private. Siperfaqet e rrugave do te rikthehen ne gjendje te meparshme sipas gjendjes qe kane: asfalt, zhavorr ose pllaka betoni. Tubacionet do te mbulohen me rere sipas specifikimeve teknike.

Ne kryqezimet e linjave do te instalohen saracineska per te mundesuar komandimin e degezimeve te vecanta. Ne pikat me te larta te rrjetit do te vendosen ajruer per te rregulluar funksionimin e tij, kurse

“Ndertim i Rrjetit shperndares te furnizimit me uje ne 14 fshatrat e Kolonjes”

ne pikat me te uleta do te instalohen shkarkues per te mundesuar shplarjen dhe zbrasjen e linjave ne rast nevoje.

Ajruesit do te ndertohen ne puseta prej betoni te armuar, kurse shkarkuesit do te komandohen me saracineska me aks. Do te instalohen gjithashtu hidrante ne pikat kyce te rrjetit prane kryqezimeve te rrugeve dhe prane institucioneve me rendesi te vecante.